

shtator 2023

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin gusht

2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin gusht

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, shtator 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit gusht 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i katërmbëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Dominimi i përmbajtjeve keqinformues të kategorizuara si "clickbait" dhe dezinformatë ka vazhduar edhe në muajin gusht 2023, ashtu si në muajin e kaluar (korrik 2023).

Ndërsa, në muajin korrik artikujt "clickbait" u kthyen në vendin e parë me sasi të përmbajtjeve, në muajin gusht përqindja e tyre është rritë edhe më tepër, pra në 32%. Përmbajtjet keqinformuese në kategorinë e dezinformatës, vazhdojnë në përqindje të njëjtë si në muajin paraprak, me 25%, duke u pasuar nga lajmi i rremë me 14%. Radhitja e përmbajtjeve keqinformuese të vlerësuara në këto tri kategori vazhdon edhe në muajin gusht, siç u radhiten në tabelën vlerësuese të muajit korrik.

Keqinformatat në kategorinë "clickbait" janë shtuar gjatë këtij muaji për arsye të publikimeve të përmbajtjeve keqinformuese në fushën e kronikës së zezë, kryesisht nga mediat reale të cilat janë vlerësuar si "clickbait". Dezinformatat kryesisht janë publikuar në fushën e politikës nga media dhe publikues të ndryshëm (portalet e dyshimta dhe publikuesit në mediat sociale). Edhe lajmet e rreme janë publikuar në fushën e politikës, kryesisht nga publikuesit në media sociale.



33% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin "clickbait".

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1

1

01. “Clickbait”

Artikujt e vlerësuar në këtë kategori janë publikuar në gjuhën shqipe nga media reale dhe një përqindje e vogël nga portale të dyshimta. Pjesa më e madhe e tyre janë krijuar e publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe atë sociale. Artikuj të ndryshëm të kronikës së zezë për raste tragjike, vrasje, aksidente e tërmete që nuk kishin ndodhur në Kosovë dhe që titujt nuk bëjnë të ditur vendndodhjen e ngjarjes, duke lënë hapësirë për keqinformim, kanë mbizotëruar në këtë kategori të vlerësimit. Ndërkaq, tematikat sociale që morën vlerësimin “clickbait” ishin për ndalimin e skuterëve elektrike, ndalimi i vajzave me veshje myslimane në shkolla, për ligjin mbi produktet ushqimore, tema këto që nuk kishin të bënin me Kosovën dhe që nuk bëhej e ditur vendndodhja e këtyre zhvillimeve.

03. Lajm i rremë

Lajmet e rreme kryesisht janë publikuar nga faqe apo llogari në mediat sociale në gjuhën shqipe. Një përqindje e madhe e tyre janë publikuar nga fusha e politikës lidhur me deklarata të pathëna të këngëtares Dua Lipa për flamurin e Shqipërisë pas rastit të këngëtares Rita Orës në një koncert ku shpalosi flamurin serb. Në mediat sociale u publikuan edhe deklarata të paqena të presidentit ukrainas, Zelensky për njohjen e shtetit të Kosovës, pretendime të pabaza për një luftë në Kosovë. Si dhe në media reale në gjuhën shqipe u publikuar pretendimi i rremë nga mediat se Kurti është parë duke hyrë në ambientet e Prokurorisë Speciale për t’u intervistuar për rastin e vajit dhe grurit.

05. Gabim

Përmbajtjet keqinformuese që janë vlerësuar gabim janë publikuar nga mediat në gjuhën shqipe në fushën e politikës, sociale dhe ekonomisë. U raportua gabimisht rreth sasisë së grurit të munguar nga rezervat shtetërore të Republikës së Kosovës, për arrestimin e zyrtarëve për korrupsion, vendimi për parkingjet me pagesë prej orës 19:00 në Prishtinë, si dhe rreth të hyrave buxhetore të Doganës së Kosovës

02. Dezinformatë

Përmbajtjet dezinformuese janë publikuar në mediat sociale dhe portale të dyshimta, kryesisht në gjuhën shqipe në fushën politike dhe të sigurisë. Dezinformatat në gjuhën shqipe, në fushën e politikës, ndërlidheshin me deklaratat e ushtruesit të detyrës së kryetarit të OVL të UÇK-së, Faton Klinakut për vrasjen e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, rreth dorëheqjes së ish-ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj. Ndërsa në gjuhën serbe dezinformatat përfshinin pretendime për agjendë për spastrim etnik të serbëve, dhe synimit të ndërlidhjes së pretendimit të pabazuar për trafikim organesh në Ukrainë me përfshirjen e UÇK-së. Përmbajtjet dezinformuese në fushën e sigurisë, në gjuhën shqipe, ishin për ngjarje tragjike në kafenenë “Bon Vivant” në Prishtinë dhe luftën në Ukrainë, kurse ato në gjuhën serbe kanë publikuar dezinformata rreth zhvillimeve në veri të Kosovës.

04. Mashtrim

01.Pothuajse të gjitha përmbajtjet mashtruese janë publikuar në fushën sociale nga faqe në mediat sociale, në gjuhën shqipe. Temat kryesore janë për dhënie të kredive dhe lojëra shpërblyese të vlerësuar si mashtrim. Pos tyre, është publikuar edhe një “deepfake” (përmbajtje mediale të fabrikuar të prodhuara duke përdorur inteligjencën artificiale) i aeroplanit me mbishkrimin “Albin Kurti – Kosova USA”.

06. Përmbajtje e paverifikuar

Përmbajtjet e paverifikuara janë publikuar nga media në gjuhën shqipe, në fushën politike dhe sociale. Ato kanë trajtuar tema të dhunimit të një fëmije në një institucion parashkollor në Ferizaj, e jo në Prishtinë dhe një përmbajtje e paverifikuar lidhur me imazhin e Jeff Bezos, shefi i Amazon, me një femër në jaht, për të cilin u pretendua se është udhëheqësi i Listës Serbe, Goran Rakiq.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: “Manipulim i fakteve”, “Teori konspirative” dhe nga kombinim i kategorive “Teori konspirative / Dezinformatë”.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Në këtë muaj (gusht 2023) kishte shumëllojshmëri të temave mbi të cilat u krijuan dhe shpërndan përmbajtjet keqinformuese. Matjet tregojnë se artikujt “clickbait” mbizotërojnë si kategori vlerësimi, atëherë edhe numri më i madh i artikujve janë në fushën e kronikës së zezë, veçanërisht në trajtimin e temave të ‘vdekjeve’ në rrethana të ndryshme. Me termin ‘vdekje’ janë koduar të gjitha përmbajtjet keqinformuese, që në formë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ndërlidhen me vdekje, si temat për vdekje nga përhapja e sëmundjeve, apo pas konsumimit të disa produkteve, si dhe nga aksidente në trafik etj., Në krahasim me muajin paraprak (korrik 2023), kur kishin mbizotëruar temat nga fusha e politikës apo sigurisë, në muajin gusht 2023, vendin kryesor e kanë ato nga fusha e kronikës së zezë.

Në këtë mënyrë, tema “vdekje” nga kronika e zezë është e para me 10%, duke u pasuar nga dhënia e kredive me 9% nga fusha sociale si rezultat i matjeve të monitorimit ditor gjatë muajit gusht 2023. Për dhënie të kredive janë publikuar, nga faqe në Facebook, përmbajtje me pretendime të rreme për ofrim të kredive në vlera të ndryshme monetare, duke përdorur simbole (logo) apo ilustrime të institucioneve financiare.

Ndërkaq, publikimet keqinformuese për veriun e Kosovës janë publikuar në media dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe, si dhe media dhe media sociale në gjuhën serbe. Publikuesit në gjuhën shqipe kanë publikuar pretendime të pabaza duke e ndërlidh shtimin e lëvizjeve të KFOR-it për shkak të ushtrimeve me veriun, si dhe pretendimin se u është bërë thirrje serbëve në veri të paguajnë faturat e rrymës. Nga ana tjetër, publikuesit në gjuhën serbe kanë publikuar e shpërndarë pretendime të pavërteta për ndalimin e barnave me origjinë nga Serbia në veri të Kosovës dhe për sulm ndaj serbëve nga ana e Policisë së Kosovës.

Gjatë muajit gusht 2023 ka pasur përmbajtje keqinformuese për disa deklarata të pathëna dhe të manipuluar të politikanëve, të këngëtares Dua Lipa për flamurin e Shqipërisë dhe pretendime të pabazuara për spastrim etnik dhe dëbim të komunitet serb në Kosovë.



29% e temave kryesore janë për raste tragjike në rrethana të ndryshme, dhënie të kredive, zhvillimet në veri dhe deklarata të manipuluar të politikanëve.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Raste tragjike

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese lidhur me artikujt për këtë tematikë janë publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe janë vlerësuar me kategorinë “clickbait”. Po ashtu, këta artikuj janë publikuar nga media dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe. Temat ndërlidheshin me vdekje nga përhapja e sëmundjeve, apo pas konsumimit të disa produkteve, si dhe nga aksidente në trafik etj., të cilave nuk u bëhet e ditur vendndodhja e ngjarjes me synim për të nxitur klikimin nga lexuesit.

03. Veriu

Gjysma e përmbajtjeve keqinformuese lidhur me veriun janë publikuar në fushën e sigurisë, kurse pjesa tjetër në fushën politike dhe sociale. Dezinformatat përbënin 50% të përmbajtjeve lidhur me këtë temë, pjesa tjetër janë vlerësuar si “clickbait”. Dezinformatat janë publikuar nga media dhe kanale në Telegram në gjuhën serbe për ndalimin e barnave me origjinë serbe në veri, ndërsa aksionin e Policisë së Kosovës kundër kontrabandës në veri pretendojnë ta paraqesin si sulm ndaj komunitetit serb atje. Përmbajtjet “clickbait” janë publikuar në media dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe lidhur me një opinion të publikuar si lajm me pretendimin se u bëhet thirrje serbëve në veri ta paguajnë faturat e rrymës dhe ndërlidhjen e pabazë të shtimit të lëvizjeve të KFOR-it për ushtrime me gjendjen në veri.

02. Dhënie e kredive


Artikujt keqinformues mbi këtë temë janë publikuar në mediat sociale, konkretisht nga faqe të dyshimta të gjuhën shqipe në Facebook dhe të gjitha prej tyre janë vlerësuar si mashtrim në fushën sociale. Ofrime mashtruese të mundësive, kampanjave e ofertave për kredi në vlera të ndryshme monetare ishin përmbajtjet e publikimeve mbi të cilat u krijuan mashtrimet.

04. Deklaratat e politikanëve

Pjesa më e madhe e përmbajtjeve keqinformuese lidhur me deklarata të manipuluar të politikanëve janë publikuar në mediat sociale, pasuar nga mediat, në gjuhën shqipe. Të gjitha artikujt në këtë temë janë në fushën politike dhe janë vlerësuar, si manipulim i fakteve, lajm i rremë dhe dezinformatë. Për këtë temë ka pasur publikime keqinformuese, deklarata të manipuluar, të rreme dhe dezinformuese të politikanëve lidhur me zhvillimet e brendshme politike në Kosovë në raportet pushtet – opozite.

Llojet e fushave

Bazuar në të dhënat e monitorimit për muajin gusht 2023, media dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës. Përderisa në media në gjuhën shqipe dhe serbe dominuan temat për rezervat shtetërore, komunitetin serb dhe veriun e Kosovës, publikuesit në mediat sociale kanë keqinformuar për disa deklarata të politikanëve lidhur me zhvillimet e brendshme politike në Kosovë në raportet pushtet – opozitë dhe politikat e zhvilluara nga Albin Kurti, si dhe deklarata të pathëna për flamurin e Shqipërisë nga ana e Dua Lipës.



Përderisa në muajin qershor 2023 kishin mbizotëruar fusha e politikës dhe sigurisë, kurse në muajin korrik 2023 kishin pësuar një rënie, megjithatë në muajin gusht 2023, publikimet keqinformuese në fushën politike kanë shënuar rritje, por fusha e sigurisë ka pësuar rënie. Krahasuar me muajin korrik 2023, shënohet një rritje prej 9% të përmbajtjeve keqinformuese në fushën e politikës (nga 28% në muajin korrik 2023, në 37% në muajin gusht 2023). Fusha e politikës pasohet nga ajo e kronikës së zezë, e cila ka rritje krahasuar me muajin korrik 2023 (nga 16% në muajin korrik 2023, në 24% në muajin gusht 2023). Këto dy fusha përbëjnë me shumë se gjysmën e përmbajtjeve keqinformuese për këtë muaj monitorues edhe pse këto dy fusha nuk ndërlidhen njëra me tjetrën për shkak se të gjitha përmbajtjet keqinformuese të vlerësuara si “clickbait” janë nga kronika e zezë, ndërsa një përqindje e konsiderueshme e dezinformatave i përkasin temave politike.

Sa i përket artikujve keqinformues në fushën sociale, ato nuk kanë ndryshuar prej muajit paraprak, gjegjësisht 22% e publikimeve janë tema sociale si pasojë e mbizotërimit të përmbajtjeve mashtruese për dhënie të kredive me vlerat monetare të ndryshme dhe lojëra shpërblyese. Fusha sociale pasohet nga ajo e sigurisë, e cila ka pësuar rënie prej 15% krahasuar me muajin korrik 2023, që ndërlidhet me reduktimin e keqinformatave lidhur me veriun.

Sa i përket publikimeve keqinformuese nga fusha e politikës, 21% e tyre janë publikuar nga media dhe 16% të tjera nga publikuesit në mediat sociale në këto kategori të keqinformimit: dezinformatë (10%), lajm i rremë (9%) dhe gabim (4%). Shumica e dezinformatave janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale në gjuhën shqipe në raport me deklaratat e ushtruesit të detyrës së kryetarit të OVL të UÇK-së, Faton Klinakut, kundrejt kryeministrit Kurti, deklarata tjera të politikanëve dhe dorëheqja e ish-ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj. Ndërsa një pjesë tjetër e dezinformatave u publikua nga mediat në gjuhën serbe për ndalimin e barnave me origjinë serbe në veri synohet të ndërlidhet pretendimi i pabazuar për trafikim organesh në Ukrainë me përfshirjen e UÇK-së dhe agjendë për spastrimin etnik të serbëve nga ana e pushtetit të Kurtit. Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese të vlerësuar si “lajm i rremë” janë publikuar nga faqe dhe llogari në gjuhën shqipe, në mediat sociale, për deklaratat të pathëna të këngëtares Dua Lipa për flamurin e Shqipërisë si dhe pretendimin se Kurti është parë duke hyrë në ambientet e Prokurorisë Speciale për t’u intervistuar lidhur me rastin e vajit dhe grurit.

Përmbajtjet keqinformues nga fusha e kronikës së zezë më së shumti janë vlerësuar si “clickbait” (19%), pasuar nga dezinformatë (3%) dhe lajm i rremë (1%). Pothuajse të gjitha përmbajtjet “clickbait” janë publikuar nga media në gjuhën shqipe lidhur me vdekje dhe vrasje në rrethana të ndryshme, aksidente, tërmete, grabitje e plagosje.

Lidhur me artikujt keqinformues për çështje sociale, shumica prej tyre janë publikuar nga media sociale në gjuhën shqipe në të cilat mbizotërojnë përmbajtjet mashtruese (10%) për publikimet të rreme për dhënie të kredive, pasuar nga përmbajtje “clickbait” në gjuhën shqipe (7%) për tema mbi produkte ushqimore, ndalimin e skuterëve elektrikë, vendimin për ndalesën e veshjes myslimane në shkolla.

Kurse, keqinformimet për sigurinë janë publikuar nga media, portale të dyshimta dhe publikues në mediat sociale kryesisht në gjuhën shqipe të cilat janë vlerësuar si dezinformatë (4%), lajm i rremë (3%) dhe “clickbait” (1%).



95% e përmbajtjeve keqinformuese janë për politikën, kronikën e zezë, çështjet sociale, sigurinë dhe shëndetësinë.

Llojet e publikuesve


4

Të dhënat e monitorimit për muajin gusht 2023 tregojnë se mediat reale kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese gjatë këtij muaji. Ky është një ndryshim nga muaji paraprak (korrik 2023), kur publikuesit në mediat sociale kishin publikuar dhe shpërndarë më së shumti keqinformime lidhur me ngjarje dhe zhvillimet rreth Kosovës. Kjo kryesisht i atribuohet artikujve keqinformuese të vlerësuar “clickbait” dhe gabim që janë publikuar nga mediat reale, ndërsa publikuesit në mediat sociale kanë publikuar më tepër dezinformata, mashtrim dhe lajme të rreme.

Sipas matjeve të monitorimit, 51% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar nga mediat, 40% nga faqe dhe llogari në mediat sociale dhe 9% nga portale të dyshimta.

Krahasimi i të dhënave të këtij muaji me muajin paraprak shpërfaq se përmbajtjet keqinformuese të publikuara në mediat sociale kanë pësuar rënie prej 10% (nga 50% në muajin korrik 2023, në 40% për muajin gusht 2023), ndërsa keqinformatat në media kanë shënuar rritje të konsiderueshme prej 11% (nga 39% në muajin korrik 2023, në 51% në muajin gusht 2023).

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




91% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga media (51%) dhe nga publikuesit në mediat sociale (40%).

5

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në raport me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Gjatë këtij muaji, publikuesit të ndryshëm në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 90% ngjashëm si në muajt paraprak. Prej tyre publikimeve në gjuhën shqipe, 42% e artikujve keqinformues në gjuhën shqipe (që përbën mostrën më të madhe të monitorimit) janë publikuar nga mediat, 39% nga publikues në mediat sociale dhe 9% nga portale të dyshimta. Ndërsa, publikimet keqinformuese në gjuhën serbe janë publikuar nga 9% e mediave të monitoruara për publikime me përmbajtje për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë, si dhe 1% nga publikues në mediat sociale.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe

Përmbajtjet keqinformuese gjatë muajit gusht 2023 janë publikuar përafërsisht në përqindje të njëjtë nga mediat (42%) dhe faqe e llogari në mediat sociale (39%), duke u pasuar nga portalet e dyshimta (9%). Edhe gjatë këtij muaji, si në muajin paraprak (korrik 2023) vazhdon të dominojë kategoria “clickbait” për shkak të përmbajtjeve nga kronika e zezë (vdekje, vrasje, aksidente etj.), ndërsa gabimi radhitet i dyti me 7%. E treta radhitet përmbajtje e paverifikuar (3%), ndërsa në vendin e katërt manipulimi i fakteve (1%). Përkundër faktit që prinë fusha e politikës në publikimet në gjuhën shqipe, në vendin e dytë dhe të tretë radhiten kronika e zezë dhe sociale me një dallim të vogël nga njëra-tjetra. Kjo buron si rezultat i asaj se temat politike janë kategorizuar në disa lloje vlerësuese (lajm i rremë, dezinformatë, “clickbait” dhe gabim), nga kronika e zezë kanë dominuar përmbajtjet “clickbait”, ndërsa tek çështjet sociale përmbajtjet mashtruese. Përderisa në fushën politike ak pasur një shumëllojshmëri të temave, në fushat tjera kanë dominuar temat për ngjarje që nuk kanë ndodhur në Kosovës e që lidhen me raste tragjike të ndryshme, si dhe publikime mashtruese për dhënie të kredive në vlera të ndryshme monetare.

02. Publikimet në gjuhën serbe

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të publikuesve në gjuhën serbe janë tema politike dhe të sigurisë në lidhje me ngjarjet në Kosovë gjatë muajit gusht 2023. Si kategori mbizotërojnë dezinformatat , duke u pasuar nga teoritë konspirative dhe lajm i rremë. Dezinformatat e publikuara në publikuesit në gjuhën serbe janë pretendime të pabaza për ndalimin e barnave me origjinë serbe në veri të Kosovës, sulm ndaj serbëve dhe agjendë për spastrim etnik të tyre nga ana e pushtetit të Kurtit, si dhe synimi nga mediat në gjuhën serbe të ndërlidhet pretendimi i pabazuar për trafikim organesh në Ukrainë me përfshirjen e UÇK-së. Po ashtu, publikuesit në gjuhën serbe kanë shpërndarë artikujt me përmbajtje të teorisë konspirative se Turqia dhe Britania e Madhe po përgatisin terren që Kurti ta sulmojë Serbinë, si dhe kërcënimi për dëbim të serbëve nga Kosova.


Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Ngjashëm si në muajin paraprak (korrik 2023), edhe në muajin gusht 2023 prijnë përmbajtjet keqinformuese të publikuesve në Facebook me të njëjtën përqindje (68%). Ndërsa, keqinformimet në TikTok kanë shënuar një rritje gjatë muajit gusht 2023 prej 5% krahasuar me muajin paraprak (nga 23% sa ishte në korrik 2023, në 28% në gusht 2023).

Në këtë mënyrë, 68% e përmbajtjeve keqinformuese u publikuan dhe shpërndan në Facebook, pasuar nga TikTok me 28% dhe një përqindje e vogël në Telegram (4%).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje analizon, përmes të dhënave monitoruese, ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Në muajin gusht 2023, faqet e ndryshme në Facebook (56%) kanë publikuar më së shumti keqinformata lidhur me zhvillimet në Kosovë, ndërsa pjesa tjetër e përmbajtjeve keqinformuese në këtë media sociale janë publikuar nga mediat (12%). Edhe gjatë muajit korrik 2023, faqet në Facebook kanë mbizotëruar sa i përket shpërndarjes së artikujve keqinformues, duke u pasuar nga llogari në TikTok (28%) dhe kanale në Telegram (4%).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

01.Shumica e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në Facebook janë nga fusha sociale dhe politike. Pjesa dërrmuese e publikimeve keqinformuese nga fusha sociale përfshin përmbajtje mashtruese lidhur me dhënie të kredive në vlera të ndryshme monetare, si dhe për lojë shpërblyese. Ndërsa, artikujt me tematikë politike ndërlidhen me deklaratat të politikanëve lidhur me zhvillimet politike në vend dhe deklaratë të pathënë të këngëtares Dua Lipa për flamurin e Shqipërisë. Keqinformatat të publikuara në gjuhën shqipe në Facebook kategorizohen si mashtrim (28%), dezinformata (20%) dhe lajmi i rremë (16%). Përmbajtjet mashtruese janë të gjitha për dhënie të kredive dhe lojë shpërblyese,ndërsa dezinformatat ndërlidhen me tema të ndryshme nga politika, sociale, sporti dhe shëndetësia,

02. TikTok


01.Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga llogari në TikTok janë në fushën politike dhe të sigurisë. Temat politike ndërlidhen me pretendime të rreme se ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVL të UÇK-së, Faton Klinaku ka deklaruar që më parë e vret kryeministrin Albin Kurtin sesa Milan Radojçiqin, i cili është nën hetime nga shteti i Kosovës dhe i sanksionuar nga SHBA; se ish-ministri Armend Mehaj u detyrua të japë dorëheqje pasi vizitoi ish-krerët e UÇK-së në Hagë; se presidenti ukrainas, Zelensky ka deklaruar se Ukraina nuk e njeh Kosovën; se deputeti i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë që do ta votonte Listën Serbe para Lëvizjes Vetëvendosje; dhe një “deepfake” (përmbajtje mediale të fabrikuara të prodhuara duke përdorur inteligjencën artificiale) i aeroplanit me mbishkrimin “Albin Kurti”. Ndërsa, nga fusha e sigurisë u pretendua pa fakte për luftë të re në Kosovë. Përmbajtjet keqinformuese në TikTok kategorizohen si dezinformata (12%), lajm i rremë (12%) dhe mashtrim (4%).

03. Telegram

Publikimet në Telegram janë dukshëm në përqindje më të vogël në krahasim me Facebook dhe TikTok. Publikimi në Telegram është në gjuhën serbe për temë të sigurisë i publikuar nga një kanal në gjuhën serbe. Ky artikull përmban dezinformata lidhur me aksionin e Policisë së Kosovës kundër kontrabandës në veri të Kosovës, të cilin pretendon pa fakte të paraqes si sulm ndaj komunitetit serb atje.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.




Të gjitha institucionet e përmendura në tabelën e mësipërme janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga publikues të ndryshëm gjatë muajit gusht 2023.

Duke pasur parasysh që në mesin e institucioneve të përmendura zënë vend Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, KFOR-i dhe Policia e Serbisë, atëherë kuptohet se institucionet e sigurisë janë ndër më të përfolurat gjatë këtij muaji.

Policia e Kosovës është përfolur në dezinformatën e mediave në gjuhën serbe se aksioni i saj kundër kontrabandës në veriun e Kosovës paraqitet si sulm ndaj serbëve, ndërsa FSK-ja është përfshirë në teorinë konspirative nga mediat në gjuhën serbe se Turqia dhe Britania e Madhe po përgatitin terren që FSK-ja ta sulmojë Serbinë. KFOR-i u përfol në përmbajtjen “clickbait” të mediave në gjuhën shqipe, të cilat shtimin e lëvizjeve të KFOR-it për ushtrime të zakonshme e ndërlihdh me situatën në veri të vendit, ndërsa Policia e Serbisë në një video dezinformuese me pretendimin se paraqet duke i keqtrajtuar shqiptarët.

Institucione ose organizata tjera të përfolura janë Dogana e Kosovës, UÇK-ja, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, vazhdon të jetë figura më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese të publikuesve të ndryshëm edhe gjatë muajit gusht 2023. Kurti u përfol nga media në gjuhën shqipe lidhur me pretendimin e rremë se Kurti është parë duke hyrë në ambientet e Prokurorisë Speciale për rastin e vajit dhe grurit; në përmbajtjen mashtruese me publikimin e “deepfake” (përmbajtje mediale të fabrikuara të prodhuara duke përdorur inteligjencën artificiale) të aeroplanit me mbishkrimin “Albin Kurti – Kosova USA” nga publikues në mediat sociale; në teori konspirative të mediave në gjuhën serbe për pretendimin se Turqia dhe Britania e Madhe po përgatitin terren që Kurti ta sulmojë Serbinë etj.

Në bazë të monitorimit, Kurti, gjithashtu, është përfolur edhe në kontekst me personalitete tjera. Ai u përfshi në Tiktok në përmbajtjen dezinformuese që ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVL të UÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë së më parë e vret Albin Kurtin sesa Radojçiqin, i cili është nën hetime nga shteti i Kosovës dhe i sanksionuar nga SHBA; u përfol në deklaratën e manipuluar në media të ish-kryeministrit Isa Mustafës, që Kurti dëshiron të jap dorëheqje e të mos i zbatoj marrëveshjet; si dhe në dezinformatat në media në gjuhën serbe, në pretendimin e pabazë të Ministrisë të Mbrojtjes të Serbisë, Millosh Vuçeviqit se pushteti i Kurtit ka agjendë për spastrim etnik të serbëve.

Si figurë e dytë më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese gjatë këtij muaji zë vend Dua Lipa me disa deklarata të pathëna për flamurin e Shqipërisë pas rastit të ndodhur të Rita Orës më flamurin serb. Personalitetet tjera të përfolura janë boksieri Haxhi Krasniqi, Sabri Fejzullahu, Dritan Abazoviq, Goran Rakiq, Alicia Kerns, Maria Zakharova dhe të tjerë.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar – IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 gusht 2023.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit gusht 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Në bazë të monitorimit për muajin gusht 2023, mediat dhe publikuesit e ndryshëm kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti artikuj “clickbait” me 33%, pasuar nga dezinformata me 26% dhe lajmi i rremë me 14%, ndërsa përmbajtjet mashtruese zënë vendin e katërt me 12%. Pjesa më e madhe e përmbajtjeve “clickbait” janë krijuar e publikuar në fushën e kronikës së zezë me 18% dhe sociale me 8% nga media dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe. Ndërsa, dezinformatat janë publikuar nga publikues në media sociale dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe, si dhe nga media në gjuhën serbe në fushën e politikës dhe sigurisë. Lajmet e rreme kryesisht janë shpërndarë nga faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe, shumica prej tyre në fushën e politikës. Të gjitha përmbajtjet mashtruese janë publikuar nga publikues në mediat sociale në gjuhën shqipe lidhur me temat sociale si, dhënie të kredive dhe lojë shpërblyese.

Media dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës, e cila pasohet nga ajo e kronikës së zezë. Përkundër që nuk ndërlidhen njeri me tjetrën, këto dy fusha përbëjnë me shumë se gjysmën e përmbajtjeve keqinformuese për këtë muaj monitorues, për shkak se të gjitha përmbajtjet keqinformuese të vlerësuara si “clickbait” janë nga kronika e zezë, ndërsa një përqindje e konsiderueshme e dezinformatave i përkasin temave politike.

Përmbajtjet keqinformuese që janë ndërlidhur me humbje jete në rrethana të ndryshme dhe që janë koduar si ‘raste tragjike’ kanë dominuar sa i përket temave. Kjo temë nga fusha e kronikës së zezë mbizotëron me 10%, duke pasuar nga temat tjetër sociale për dhënie të kredive me 9%. Gjatë muajit gusht 2023, veriu i Kosovës si tematikë zë vendin e tretë me 6%, pasuar nga disa deklarata të politikanëve me 4%. Të gjitha përmbajtjet lidhur me tematikën e rasteve tragjike janë publikuar nga media në gjuhën shqipe dhe janë kategorizuar si “clickbait”, ndërsa ato për dhënien e kredive nga faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe duke u kategorizuar si mashtrim. Ndërsa, përmbajtjet keqinformuese për veriuin e Kosovës janë publikuar nga media dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe, si dhe media dhe publikues në media sociale në gjuhën serbe.

Krahasuar me muajin paraprak (korrik 2023), kur mediat sociale prinin në publikimin e artikujve keqinformues, në këtë muaj (gusht 2023), mbi gjysma prej tyre ose 51 janë publikuar nga mediat reale. Pjesa tjetër e përmbajtjeve keqinformuese janë krijuar e shpërndarë nga publikues në mediat sociale me 40% dhe portale të dyshimta me 9%.

Bazuar në monitorimin gjatë muajit gusht, 90% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar nga publikues (media, portale të dyshimta dhe faqe, llogari në media sociale) në gjuhën shqipe, ndërsa 10% nga publikues (media dhe kanale në Telegram) në gjuhën serbe. Përderisa, keqinformatat në gjuhën shqipe kanë përfshi fushën e politikës, kronikës së zezë dhe sociale, ato në gjuhën serbe janë nga politika dhe siguria.

Shumica e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe janë kategorizuar si “clikckbait” me 28%, gabim me 7% dhe përmbajtje e paverifikuar me 3%, ndërsa në mediat sociale janë publikuar dezinformata (13%), mashtrim (12%) dhe lajm i rremë (12%). Politika dhe kronika e zezë kanë qenë dy fushat mbi të cilat u keqinformua më së shumti nga media dhe publikues në gjuhën shqipe. Ndërsa, përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe janë nga fusha e politikës dhe sigurisë për tema, si ndalimin e barnave me origjinë serbe në veri, pretendimin e pabazuar për trafikim organesh në Ukrainë me përfshirjen e UÇK-së, pretendimin për agjendë për spastrimin etnik të serbëve nga ana e pushtetit të Kurtit etj. Sa i përket publikimeve nga publikuesit në media sociale, 68% e tyre janë publikuar në Facebook, duke u pasuar nga TikTok me 28% dhe Telegram me 4%. Të gjitha përmbajtjet janë në gjuhën shqipe, përveç përmbajtjes në Telegram që është në gjuhën serbe. Temat kryesore të trajtuara janë çështjet politike dhe sociale.

Institucionet e sigurisë si, Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, KFOR-i, dhe Policia e Serbisë janë më të përfolurat në keqinformatat e publikuara nga publikuesit në gjuhën shqipe dhe serbe. Si personalitet, Albin Kurti ka vazhduar të ketë vëmendjen më të madhe në përmbajtjet keqinformuese edhe këtë muaj, kryesisht për zhvillime politike duke u ndërlidhur në kontekst me personalitete të tjera politike vendore dhe serbe.

HIBRIDO.INFO